

# UDHËTIMI I SHTETASVE TË HUAJ ME KAFSHË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

± =

## ***I-INFORMACION MBI UDHËTIMIN E TË HUAJVE ME KAFSHË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË***

Në zbatim të nenit 33, pika 5 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kafshët e shoqërimit të cilat, për qëllime jo tregtare, hyjnë për në ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë përmes Pikave të Inspektimit Kufitar (PIK), shoqërohen me dokumentacionin veterinar që i nënshtrohen kontrollit veterinar në PIK.

Kërkesat që duhet të plotësohen mbi lëvizjen e kafshëve shtëpiake të shoqërimit nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian janë si me poshtë:

**1.** Kur lëvizin, kafshët shtëpiake (qentë, mace, lepuj etj. ), duhet:

- ❖ të jenë të identifikuar (nga një tatuazh i lexueshëm qartësisht, ose nga një sistem identifikimi elektronik, ose nga matrikull)
- ❖ të jenë të shoqëruara nga një pasaportë e lëshuar nga një veteriner zyrtar duke vërtetuar që është kryer vakcina kundër tërbimit dhe kur është e nevojshme, mbi kafshët në fjalë janë kryer masa parandaluese lidhur me sëmundje të tjera

**2.** Lejohet lëvizja e kafshëve shtëpiake të shoqërimit (qentë, macet etj.), të cilat janë nën moshën 3 muaj dhe të pa vaksinuara, në qoftë se janë të shoqëruara nga një pasaportë dhe kanë qëndruar në vendin në të cilin ato kanë lindur që nga lindja pa pasur kontakt me kafshë të egra të cilat kanë qenë të ekspozuara ndaj infeksionit ose shoqërohet nga mëmat e tyre nga te cilat ato janë akoma të varura.